



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.62

14 maj

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 117 datë 23.4.2009	Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.....	2825
Ligj nr. 10 118 datë 23.4.2009	Për dhënien e së drejtës së përdorimit, për 15 vjet, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit të ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sh.a., sipas procedurës “Tender i hapur ndërkombëtar” të datës 20.2.2009.....	2826
Ligj nr.10 120 datë 23.4.2009	Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore.....	2828
Kërkesë e MF nr.2976/3, datë 7.4.2009	Për shpronësimin, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi i degës doganore Tiranë	2841
Kërkesë e MPPTT nr.2080/1, datë 6.4.2009	Për shtesë shpronësimi, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë.....	2841
Kërkesë e MPPTT nr.2243, datë 3.4.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë-Qafë Plloçë.....	2844
Kërkesë MPPTT nr.1870/1, datë 6.4.2009	Për shtesë shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.	2846
Vendim i ERE nr.26, datë 9.4.2009	Për ndryshimin e licencës me nr.16, seria PV04P, për prodhimin e energjisë elektrike, lëshuar shoqërisë “WTS energji” sh.p.k., me vendim të Bordit të komisionerëve të ere-s, nr.39, datë 22.7.2004.....	2853

LIGJ
Nr.10 117, datë 23.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 11 “Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël” pika 5, fjalët “në kufijtë plus/minus 30 për qind” zëvendësohen me fjalët “në kufijtë plus 10/minus 30 për qind”.

Neni 2

Në nenin 21 “Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme”, fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ndërsa për tatimpaguesit e biznesit të vogël kufijtë janë plus 10/minus 30 për qind.”.

Neni 3

Në nenin 32 “Taksa të tjera” bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“b) bazën dhe nivelin për taksën e tabelës, e cila, së bashku me taksat dhe tarifatat e aplikueshme, nuk duhet të jetë më shumë se 10 për qind e nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, sipas kategorisë së rrethit dhe qarkullimit vjetor.”.

2. Në shkronjën “ç” të pikës 2, fjalët “në kufijtë +/- 30 për qind” zëvendësohen me fjalët “në kufijtë plus 10/minus 30 për qind.”.

Neni 4

Neni 33 “Taksat e përkohshme vendore” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Këshilli bashkiak ose komunal, kur e gjykon të domosdoshme, vendos taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të komunitetit, në territorin brenda juridiksionit të tij. Masa e taksave me karakter të përkohshëm, së bashku me taksat dhe tarifatat e aplikueshme, nuk duhet të kalojnë kufirin plus 10 për qind të nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të këtij biznesi.”.

Neni 5

Në nenin 35 “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mbliidhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent, por në asnjë rast shuma e tarifave vendore, të aplikueshme për tatimpaguesit e biznesit të vogël, nuk duhet të kalojë 10 për qind të nivelit tregues të taksës, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël.

Në rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë ose i komunës bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6158, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr. 10 118, datë 23.4.2009

**PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT, PËR 15 VJET, NË BREZIN
E FREKUENCAVE E-GSM DHE GSM 1800, BASHKIMIT TË OFERTUESVE,
PËRFAQËSUAR NGA POSTË TELEKOMUNIKACIONI I KOSOVËS SHA,
SIPAS PROCEDURËS “TENDER I HAPUR NDËRKOMBËTAR”
TË DATËS 20.2.2009**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Dhënien e së drejtës së përdorimit, për 15 vjet, kundrejt çmimit 7 200 000 (shtatë milionë e dyqind mijë) euro, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit të ofertuesve, të përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, sipas kushteve të ofertës, të dorëzuar tek Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në përputhje me kërkesat e dokumentacionit standard të procedurës “Tender i hapur ndërkombëtar” të datës 20.2.2009.

Neni 2

Ndalohet, pa vënë në efijencë shërbimin e telekomunikacionit në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, çdo transferim pakete aksionesh apo të drejtash, sipas nenit 1 të këtij ligji,

nga subjekti Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, me adresë: Lagjja “Dardania”, Prishtinë-Kosovë, të tretëve, përfshirë dhe bashkimit të ofertuesve të tjerë. Ky ndalim përfundon në çdo kohë, kur bashkimi i ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha ka bërë eficient rrjetin në parametrat: mbulim 95 për qind të popullsisë dhe 85 për qind të territorit.

Kuvendi i Shqipërisë mund të vendosë ndryshe, me kërkesë të motivuar të subjektit Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, për rrethana të veçanta të tij, të tilla si: likuidim, falimentim apo gjendje paaftësie paguese të këtij subjekti.

Neni 3

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, t'u dërgojë njoftimin fituesve, bashkimit të ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha dhe të vijojë procedurën për autorizimin individual, sipas dokumentacionit të tenderit.

Neni 4

Ky ligj nuk krijon asnjë efekt kur bashkimi i ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, nuk likuidon, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendrike nga data e marrjes së njoftimit, çmimin e ofertës prej 7 200 000 (shtatë milionë e dyqind mijë) eurosh.

Kur bashkimi i ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, nuk likuidon në masë të plotë shumën 7 200 000 (shtatë milionë e dyqind mijë) euro, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendrike nga data e marrjes së njoftimit, garancia e shoqërisë së sigurimeve ALBSIG, e derdhur për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si depozitë e rimbursueshme, në shumën 100 000 (njëqind mijë) euro, në numër serie 11086639, datë 20.2.2009, e vlefshme për periudhën 150 ditë kalendrike pas datës 20.2.2009, kalon për llogari të shtetit shqiptar.

Neni 5

Dokumentacioni standard i tenderit të hapur ndërkombëtar, i hartuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe oferta e subjektit, dorëzuar pranë këtij autoriteti, janë pjesë përbërëse të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6159, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 120, datë 23.4.2009

**PËR MBROJTJEN E FONDIT TË BIMËVE MJEKËSORE,
ETEROVAJORE E TANIFERE NATYRORE**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë:

a) fondin e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, që rriten e zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke zbatuar masa mbrojtëse e administruese, tërësore për fondin e të veçanta për çdo lloj, duke respektuar kërkesat teknike për vjeljen e mbledhjen e tyre, duke nxitur e përkrahur veprimtaritë për rehabilitimin e për kultivimin e tyre;

b) llojet e kultivuara nga njeriu, në sipërfaqet e fondit të tokave pyjore, kullosore apo bujqësore, gjatë kultivimit, mbledhjes e vjeljes së tyre, si dhe llojet e kultivuara në parcela eksperimentale, në kuadër të veprimtarive kërkimore-shkencore;

c) fondin e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, që rriten e zhvillohen në gjendje natyrore në territorin e Republikës së Shqipërisë e që është pasuri kombëtare.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është tërësia e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, si dhe secili lloj, që përfshihet në fond, gjatë periudhës së rritjes, vjeljes e mbledhjes, si dhe gjatë magazinimit e transportimit të tyre, për t'ua ruajtur vlerat përdoruese e kurative të tyre.

Neni 3
Përbërja e fondit

Fondi i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore përbëhet nga llojet e nënllojet e bimëve dhe popullatat e tyre, si dhe nga habitatet, tokësore e ujore, ku ato rriten e zhvillohen në gjendje natyrore, si pjesë e rëndësishme e florës së vendit.

Neni 4
Përkufizimi i termave

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Fondi i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET)” është tërësia e llojeve të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, si dhe habitatet, ku ato rriten e zhvillohen në mënyrë natyrore, në territoret e Republikës së Shqipërisë.

2. “Bimët mjekësore” janë bimët e njohura për vlerat e tyre terapeutike.

3. “Bimët eterovajore” janë bimët, prej të cilave ekstrahohen vajra eterike dhe esenca.

4. “Bimët tanifere natyrore” janë bimët, prej të cilave ekstrahohet substanca e taninit.
5. “Regjistër i BMET-ve” është dokumenti zyrtar, i formatuar, ku regjistrohen, ruhen e përditësohen të dhënat kryesore për secilin lloj të bimëve e të sipërfaqeve ku ato rriten, shoqëruar me hartat përkatëse.
6. “Trajtim i fondit të BMET-ve” është tërësia e masave ligjore, administrative, ekonomike dhe e operacioneve teknike, që merren për ruajtjen e bimëve dhe vazhdimësinë e rigjenerimit natyror të tyre.
7. “Dëmtim i fondit të BMET-ve dhe i mjedisit të tyre” është prishja e elementeve fizike, kimike e strukturore të ekosistemit, që ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e prodhimitarisë, në pakësimin e shumëllojshmërisë së bimëve apo në cilësitë e tyre.
8. “Mbrojtje e fondit të BMET-ve” janë veprimtaritë, që parandalojnë degradimin e tokës, ruajnë llojshmërinë e mbulesës bimore, i përmirësojnë ato dhe infrastrukturën e tyre nga ndikimet negative të faktorëve, njerëzorë e natyrorë.
9. “Plan mbarështimi” është dokumenti shtetëror për administrimin e fondit të BMET-ve, si dhe masat që parashikohen për trajtimin e qëndrueshëm të tyre, organizimin, planifikimin e masave mbrojtëse dhe përcaktimin e kapaciteteve për mbledhjen e vjeljen e tyre.
10. “Rehabilitimi” është tërësia e masave dhe e veprimeve të karakterit kërkimor-shkencor e zbatues, që synon përmirësimin e një situate të dëmtuar dhe rivendosjen e gjendjes së mëparshme të llojeve.
11. “Kultivimi” është veprimtaria e mirëfilltë agronomike në tokat e fondit bujqësor, pyjor dhe kullësor, për të mbjellë dhe rritur lloje të caktuara të BMET-ve, për qëllime ekonomike e tregtare.
12. “Manual i BMET-ve” është përmbledhja e rregullave dhe e kërkesave teknike-profesionale për mbrojtjen, administrimin, rehabilitimin, vjeljen, tharjen, ambalazhimin dhe transportin e BMET-ve, të miratuara nga ministri dhe të detyrueshme për zbatim.
13. “Lista e BMET-ve” është tërësia e llojeve dhe e nënlojeve të këtyre bimëve, që rriten në gjendje natyrore, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Lista dhe materiale të tjera, si atlase e albume të këtyre bimëve, përgatiten nga institute e qendra kërkimore-shkencore dhe publikohen nën kujdesin e ministrisë.
14. “Rilevimet floristike” janë punimet fitogjeografike e topografike, në një sipërfaqe të caktuar toke, si përfaqësuese të një bashkëshoqërimi bimor, për marrjen e të dhënave për llojet, për prodhimitarinë, për cilësinë dhe mundësitë e çdo lloji bime, që përdoren për përgatitjen e planeve të mbarështimit e të hartave përkatëse.
15. “Lista e kuqe” është listimi i llojeve e i nënlojeve të florës dhe faunës, që meritojnë status të veçantë mbrojtjeje e që miratohet me urdhër të ministrit.
16. “Ministria” është ministria përgjegjëse për fondin e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore.
17. “Ministër” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për fondin e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore.

Neni 5

Pronësia mbi BMET-të

1. Pronësia mbi BMET-të buron nga pronësia e tokës, ku ato rriten e zhvillohen dhe njësohet me të:
 - a) llojet, që rriten e zhvillohen në fondin pyjor e kullësor publik, janë pronë shtetërore;
 - b) llojet, që rriten e zhvillohen në pyjet e kullotat komunale, janë pronë e komunave/bashkive;
 - c) llojet, që rriten e zhvillohen në pyje e kullota private apo në tokat bujqësore të fermerëve, janë pronë private.
2. Llojet, që rriten nëpërmjet veprimtarive rehabilituese e kultivuese, janë pronë e rehabilituesit ose e kultivuesit, edhe pse ata mund të mos jenë pronarë të tokës.

Neni 6
Kushtet dhe kërkesat teknike

1. Kushtet dhe kërkesat teknike, si tërësi rregullash për mbrojtjen, administrimin, rehabilitimin, vjeljen, tharjen, ambalazhimin dhe transportin e BMET-ve, janë të njëjta dhe detyrimisht të zbatueshme për të gjitha format e pronësisë.

2. Kushtet dhe kërkesat teknike, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen në një manual të veçantë, që miratohet nga ministri.

KREU II
MBROJTJA DHE ADMINISTRIMI I FONDIT TË BMET-VE

Neni 7
Synimet e mbrojtjes

Mbrojtja e fondit të BMET-ve, si tërësi veprimesh e masash të detyrueshme, që ndërmerren nga subjektet publike e private, të përmendura në nenin 11 të këtij ligji, synon:

- a) ruajtjen e larmisë së llojeve, ku dhe kur ajo rrezikohet;
- b) mbrojtjen e sipërfaqeve e të territoreve ku rriten e zhvillohen këto bimë;
- c) plotësimin e kërkesave e të kushteve të zhvillimit e të shumimit të tyre;
- ç) ruajtjen e integritetit natyror të secilit lloj;
- d) përdorimin e llojeve për qëllime studimore-shkencore, që sigurojnë vazhdimësinë e tyre;
- dh) ndihmën për mbijetesën e llojeve në kushte të vështira e në raste fatkeqësish natyrore;
- e) rehabilitimin dhe shtimin e popullatave të llojeve të dëmtuara e në rrezik zhdukjeje;
- ë) mbrojtjen e veçantë të llojeve në rrezik zhdukjeje, deri në normalizimin e gjendjes së tyre;
- f) ruajtjen e gjendjes shëndetësore të llojeve, duke luftuar infeksionet dhe sëmundjet që i prekin.

Neni 8
Masat mbrojtëse

1. Për të realizuar mbrojtjen e fondit të BMET-ve, ministria organizon dhe drejton plotësimin e kërkesave e marrjen e masave, si më poshtë:

- a) siguron mbrojtjen tërësore për fondin dhe të veçantë për llojet e tij, në përputhje me gjendjen konkrete të llojit dhe të habitatit ku jeton;
- b) u jep status të veçantë mbrojtës llojeve të kërcënuara e në rrezik zhdukjeje;
- c) realizon ruajtjen dhe rehabilitimin, kur është e mundur, të habitateve natyrore të llojeve;
- ç) ndërmerr rimëkëmbjen e popullatave të pakësuara të llojeve në një apo në disa habitate të caktuara;
- d) shmang keqtrajtjet e dëmtimet e llojeve gjatë veprimtarive bujqësore, hidroteknike, të mirëmbajtjes e shfrytëzimit të pyjeve dhe veprimtarive të tjera ekonomike e shoqërore, që mund t'i dëmtojnë;
- dh) krijon zona të mbrojtura, duke pasur si bazë edhe habitatet e llojeve;
- e) realizon shtimin ex-situ të llojeve të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje;
- ë) organizon kërkime shkencore për mbrojtjen e llojeve;
- f) nxit e përkrah projekte e veprimtari të biznesit, të OJF-ve e të donatorëve, që synojnë mbrojtjen dhe shtimin e popullatave të llojeve të BMET-ve;
- g) informon dhe ndërgjegjëson publikun për mbrojtjen e BMET-ve.

2. Zbatimi në praktikë i kërkesave të pikës 1 të këtij neni realizohet nga strukturat e shërbimit pyjor të ministrisë, të cilat, nëpërmjet shërbimit të ekstensionit, asistojnë edhe njësitë tekniko-organizative, që veprojnë në njësitë e qeverisjes vendore për pyjet dhe kullotat komunale.

Neni 9

Mbrojtja e llojeve të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje

1. Llojet e kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje, të përfshira në listën e kuqe, gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore, që nënkupton:

a) hartimin dhe zbatimin e planeve të veçanta të veprimit, për ruajtjen e këtyre llojeve, sidomos kur shumimi i tyre, në kushte natyrore, është shumë i kufizuar;

b) monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes faktike e të ecurisë së popullatave të llojeve;

c) ndalimin e përkohshëm të vjeljes, mbledhjes e grumbullimit të tyre;

ç) përfshirjen e habitateve të tyre si nënzona konkrete, që favorizojnë mbrojtjen dhe shumimin e tyre në zonat që shpallen të mbrojtura;

d) ndalimin dhe kufizimin e veprimtarive njerëzore, që çojnë në shkatërrimin e llojeve të kërcënuara e në rrezik zhdukjeje, në zvogëlimin e numrit të popullatave e në dëmtimin e habitateve të tyre;

dh) zhvillimin e veprimtarive kërkimore-shkencore dhe të veprimtarive zbatuese, për nxjerrjen e llojeve nga statusi i mbrojtur.

2. Për zbatimin e kërkesave të pikës 1 të këtij neni, strukturat e shërbimit pyjor të ministrisë bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore, me Universitetin Bujqësor, me shoqatat e grumbulluesve të BMET-ve e me OJF-të e profilizuara për biodiversitetin.

Neni 10

Administrimi dhe trajtimi

Administrimi dhe trajtimi i fondit të BMET-ve organizohen dhe drejtohen nga ministria, zbatimi praktik i tyre është përgjegjësi e strukturave të shërbimit pyjor dhe realizohet në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, që synon:

a) ruajtjen dhe shtimin e vazhdueshëm të burimeve natyrore të fondit të BMET-ve;

b) ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe të gjallë të ekosistemeve natyrore, ku ato zhvillohen;

c) përkujdesjen dhe trajtimin shkencor të tyre, që të mos u cenohen vlerat e vetitë;

ç) respektimin rigoroz të kriterëve e kërkesave teknike, që të mos dëmtohen llojet, aftësitë përtëritëse e riprodhuese të tyre;

d) mosasgjësimin e bimëve, si pasojë e vjeljes, grumbullimit e mbledhjes së tyre;

dh) ndalimin e veprimeve, që çojnë në shkatërrimin e popullatave, pakësimin e llojeve e në varfërimin e fondit të BMET-ve.

Neni 11

Organet përgjegjëse

1. Ministria, me strukturat e veta të pyjeve dhe kullotave, përgjigjet për mbrojtjen dhe administrimin e fondit të BMET-ve, duke marrë masa për parandalimin e sëmundjeve, të dëmtimeve nga mbledhjet e grumbullimet pa kriter, nga ndikimet negative të veprimtarive ekonomike e shoqërore, që ushtrohen pranë tyre dhe nga zjarret e fatkeqësitë natyrore.

2. Organet e qeverisjes vendore, si dhe pronarët privatë të pyjeve e kullotave mbrojnë, administrojnë dhe shfrytëzojnë lloje të fondit të BMET-ve, që rriten në pyjet e kullotat, që kanë në pronësi apo në përdorim, duke respektuar kriteret teknike dhe kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 12

Strategjia dhe planet e veprimit

1. Veprimtaritë për ruajtjen, trajtimin dhe përdorimin e fondit të BMET-ve mbështeten në strategjinë dhe planet e veprimit, për ruajtjen dhe zhvillimin e këtij fondi. Strategjia dhe planet e veprimit pasqyrojnë:

a) politikat për ruajtjen dhe trajtimin e mjediseve natyrore, ku rriten e zhvillohen llojet e BMET-ve;

b) zgjerimin e mundësive për rritjen e investimeve publike e private për fondin e BMET-ve dhe angazhimin e bizneseve në to;

c) promovimin e zgjidhjeve e të rrugëve të reja, për një trajtim shkencor të fondit të BMET-ve, që synojnë rritjen e sasisë e të cilësive të tyre;

ç) programimin për zbatim të masave të parashikuara, duke caktuar afatet e zbatimit e kostot përkatëse.

2. Strategjia dhe planet e veprimit për BMET-të janë pjesë e strategjisë, planeve të veprimit dhe e programeve të pyjeve e kullotave. Ato hartohen dhe miratohen sipas dispozitave të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

Neni 13

Planet e mbarështimit

1. BMET-të administrohen në përputhje me planet e mbarështimit dhe të inventarizimit, që hartohen për to e që miratohen nga ministri, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

2. Planet e mbarështimit të pyjeve e kullotave përmbajnë edhe llojet e BMET-ve, që rriten në sipërfaqet pyjore e kullosore, hartat e shpërndarjes së tyre në këto sipërfaqe, masat për ruajtjen e tyre, si dhe mundësitë vjetore të mbledhjes për çdo lloj.

Neni 14

Inventarizimi dhe rilevimet floristike

1. Fondi i BMET-ve, që rriten në pyje e kullota, inventarizohen sipas llojeve dhe për to kryhen rilevimet floristike. Për sipërfaqet pyjore e kullosore shtetërore, inventarizimi dhe rilevimet bëhen nga drejtoritë e shërbimit pyjor, për pyjet e kullotat komunale bëhen nga njësitë tekniko-organizative, që funksionojnë në qeverisjet vendore, ndërsa në pyjet e kullotat private, nga pronari privat.

2. Inventarizimi bëhet çdo 5 vjet dhe rezultatet e tij pasqyrohen në regjistrat, që administrohen nga drejtoritë vendore të shërbimit pyjor e në regjistrin kombëtar të BMET-ve, që administrohet nga drejtoria përkatëse në ministri, formati i të cilëve miratohet nga ministri.

3. Regjistrat e fondit të BMET-ve krijojnë bazën e të dhënave për bimët, në shkallë vendi, qarku, rrethi, komune dhe për çdo ekonomi pyjore e kullosore.

4. Ngarkohen strukturat e shërbimit pyjor, organet përkatëse të qeverisjes vendore dhe pronarët e pyjeve e kullotave private që, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përfundojnë inventarizimin e BMET-ve në pyjet e kullotat që kanë në zotërim, në përputhje me rregullat e procedurat e inventarizimit, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit.

5. Rezultatet e inventarizimit, në shkallë vendi, përpunohen dhe publikohen nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, si dhe trajtohen si zë i veçantë në raportin e gjendjes së mjedisit.

Neni 15

Të dhënat operative

1. Për të kontrolluar në vijimësi gjendjen fitosanitare të BMET-ve dhe prekjet e mundshme të tyre nga sëmundjet e infeksionet, me qëllim që të merren masa përmirësuese, ministria, kur e vlerëson të nevojshme, kërkon për to të dhëna, që lidhen me shëndetin dhe sëmundshmërinë e tyre.

2. DSHP-të, njësitë tekniko-organizative, që funksionojnë në njësitë e qeverisjeve vendore, për pyjet e kullotat komunale, si dhe pronarët privatë të pyjeve e kullotave, ku rriten BMET-të, përcjellin në ministri të dhënat, sipas pikës 1 të këtij neni, duke plotësuar kërkesën e formatuar prej saj.

Neni 16 **Rehabilitimi**

1. Llojet e BMET-ve me popullata të pakësuara, të rralla e në rrezik zhdukjeje, i nënshtrohen rehabilitimit, i cili synon përmirësimin rrënjësor të gjendjes së llojeve, duke shtuar popullatat e tyre dhe duke shmangur ose zbutur ndikimet negative të faktorëve, që i kanë rrezikuar.

2. Rehabilitimi kryhet në sipërfaqet ku llojet janë rritur tradicionalisht në gjendje natyrore dhe realizohet nga institutet kërkimore-shkencore ose nga persona juridikë e fizikë, në bazë të një projekti teknik, të miratuar nga DSHP-të përkatëse ose qeverisja vendore, kur rehabilitimi i llojeve do të kryhet në sipërfaqe të pyjeve e kullotave komunale.

Neni 17 **Sipërfaqet për rehabilitimin e llojeve të dëmtuara e në rrezik zhdukjeje**

1. Nga fondi pyjor e kullosor që administrojnë, çdo fillim viti, DSHP-të shpallin listën e sipërfaqeve të BMET-ve, në të cilat, në përputhje me planet e mbarështimit, parashikohet rehabilitimi i llojeve të dëmtuara e në rrezik zhdukjeje.

2. Listat e sipërfaqeve, së bashku me kërkesat teknike të rehabilitimit të llojit dhe me kërkesat e kushtet e konkurrimit, sipas dispozitave të nenit 18 të këtij ligji, vihen në dispozicion të subjekteve, që duan të angazhohen në rehabilitim, në bazë të procedurave të konkurrimit. Me fituesin, drejtorja e shërbimit pyjor lidh kontratë.

3. Kontrata e përdorimit të sipërfaqeve për rehabilitim të llojeve të dëmtuara e në rrezik zhdukjeje të BMET-ve lidhet me personin juridik apo fizik fitues, për një afat deri në 10 vjet.

4. Sipërfaqet e fondit pyjor e kullosor, në të cilat do të rehabilitohen lloje të BMET-ve, mund të jepen njëkohësisht edhe për ushtrim veprimtarish të tjera, si mbarështim të faunës së egër, pyllëzime e kullotje, me kusht që këto veprimtari të mos pengojnë rehabilitimin e llojeve të dëmtuara e në rrezik zhdukjeje dhe të hartohet, paraprakisht, marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet përdoruesve e rehabilituesit.

5. Për rehabilitimin e llojeve të dëmtuara e në rrezik zhdukjeje në pyjet e kullotat komunale, procedurat e këtij neni zbatohen nga komunat/bashkitë, që i kanë në pronësi apo në përdorim këto sipërfaqe.

Neni 18 **Kriteret dhe kushtet e konkurrimit për rehabilitim**

1. Personat juridikë e fizikë marrin pjesë në konkurrim për rehabilitim të llojeve të dëmtuara e në rrezik zhdukjeje, kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) veprimtarinë rehabilituese e kanë të mbështetur mbi një projekt teknik e plan investimesh;

b) kanë në stafet e tyre specialistë e punonjës të kualifikuar dhe zotërojnë pajisjet e domosdoshme për rehabilitimin e këtyre llojeve;

c) dëshmojnë mundësi e mbështetje të mjaftueshme financiare për zhvillimin e veprimtarisë;

ç) mbrojnë nga zjarret e nga erozioni, me mjetet e shpenzimet e veta, sipërfaqet e marra për rehabilitim.

2. Kërkesat e pikës 1 të këtij neni, personi fizik apo juridik i paraqet në formën e një vetëdeklarimi, formati i të cilit miratohet nga ministri.

3. Konkurrimi bazohet në kriteret e mëposhtme:
- a) cilësia e projektit teknik dhe vlera e investimit që do të bëhet;
 - b) tarifa që paguan për sipërfaqen që merret për rehabilitim;
 - c) numri i personave të punësuar.

Neni 19

Kultivimi i BMET-ve për qëllime ekonomike e tregtare

1. Fermerët, në tokat e tyre, si dhe personat juridikë e fizikë, që marrin në përdorim toka bujqësore ose sipërfaqe të degraduara të fondit pyjor e kullësor, për të kultivuar lloje të ndryshme të BMET-ve, për qëllime ekonomike e tregtare, janë të detyruar të respektojnë dispozitat e këtij ligji e të akteve nënligjore në zbatim të tij, për mbjelljen, rritjen, vjeljen, ambalazhimin e tregtimin e llojeve të kultivuara.

2. Për të kultivuar lloje të ndryshme të BMET-ve për qëllime ekonomike e tregtare, personat juridikë e fizikë mund të marrin në përdorim edhe sipërfaqe të degraduara të fondit pyjor e kullësor, duke zbatuar procedurat e neneve 17 e 18 të këtij ligji.

Neni 20

Mbështetja financiare

Personat fizikë e juridikë, që rehabilitojnë dhe kultivojnë lloje të BMET-ve, nuk e paguajnë tarifën për grumbullimin dhe vjeljen në sipërfaqet e rehabilituara e të kultivuara prej tyre, gjatë të gjithë periudhës së rehabilitimit apo të kultivimit.

Neni 21

Veprime të ndaluara

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohen:

- a) vjelja, mbledhja, grumbullimi i BMET-ve në sipërfaqet pyjore e kullësore, pronë shtetërore, nga persona të pakontraktuar nga DSHP-të apo njësitë e qeverisjes vendore;
- b) vjelja, mbledhja, grumbullimi i BMET-ve, në kundërshtim me kalendarin e vjeljes e të grumbullimit të secilit lloj;
- c) vjelja, mbledhja, grumbullimi i BMET-ve me mjete, mënyra e forma, që rrezikojnë ekzistencën e llojit e që çojnë në shkatërrimin e tyre;
- ç) kryerja e veprimeve, që bien në kundërshtim me kërkesat e kriteret teknike, të parashikuara në manual;

d) mbledhja e BMET-ve të rralla, të kërcënuara, në rrezik zhdukjeje, të shpallura si të tilla në listën e miratuar nga ministri.

2. Në sipërfaqet pyjore e kullësore, ku rriten e zhvillohen në gjendje natyrore BMET-të, si dhe në sipërfaqet që ato kultivohen, ndalohet të kryhen veprimtari, që çojnë në shkatërrimin, dëmtimin, uljen e prodhimit të tyre. Në mënyrë të veçantë ndalohen:

- a) hedhja dhe depozitimi i lëndëve e i mbetjeve radioaktive;
- b) hedhja dhe depozitimi i mbetjeve të çdo lloji;
- c) shkarkimet e lëndëve e mbetjeve kimike;
- ç) shkarkimet e ujërave të ndotura, industriale e urbane.

Neni 22

Miratimi paraprak

Në sipërfaqet ku rriten lloje të BMET-ve, me miratimin paraprak të drejtorive përkatëse të shërbimit pyjor dhe nën kontrollin e tyre, mund të:

- a) ndërhyhet për pasurimin dhe përmirësimin e bimësisë së sipërfaqeve pyjore e kullimore;
- b) përdoren plehra kimike;
- c) bëhet pastrimi i kullotave dhe i livadheve.

KREU III MBLEDHJA, AMBALAZHIMI E TRANSPORTI I BMET-VE

Neni 23 **Mbledhësit**

1. Mbledhësit e BMET-ve janë persona fizikë e juridikë, që angazhohen në vjelje e grumbullim, ose organizojnë vjeljen dhe mbledhjen e llojeve të BMET-ve.
2. Për vjeljen e grumbullimit të llojeve të BMET-ve, që rriten në fondin pyjor e kullimor, pronë shtetërore, DSHP-të ose njësitë e qeverisjes vendore kontrahojnë personat fizikë e juridikë.
3. Llojet e BMET-ve, që rriten në mënyrë natyrore në fondin e tokave bujqësore dhe në ledhet e arave, vilen e grumbullohen nga fermerët, pronarë të tokave bujqësore, ose nga mbledhës, të cilët janë kontraktuar nga pronarët privatë.

Neni 24 **Vjelja dhe grumbullimi**

1. Për BMET-të, që rriten në fondin pyjor e kullimor, në fillim të çdo viti, DSHP-ja miraton:
 - a) zonat ku do të vilen e mblidhen këto bimë;
 - b) afatet dhe kalendarin e vjeljes për secilin lloj;
 - c) llojet që do të vilen, mblidhen e grumbullohen.
2. Personat fizikë dhe juridikë të interesuar për mbledhjen e bimëve BMET kontrahojnë me DSHP-në ose me njësitë e qeverisjes vendore për pyjet dhe kullotat, si dhe paguajnë tarifën përkatëse.

Neni 25 **Kontrata**

1. Në kontratën, që subjekti lidh me DSHP-në ose njësinë e qeverisjes vendore për sipërfaqet e pyjeve apo të kullotave komunale, veç të tjerash, përcaktohen edhe:
 - a) sipërfaqja ku do të mblidhen bimët;
 - b) llojet e bimëve që do të mblidhen;
 - c) afatet e grumbullimit të bimëve;
 - ç) tarifa e grumbullimit të bimëve, në përputhje me llojet dhe sasinë e miratuar, e cila paguhet njëherësh, në çastin e lidhjes së kontratës.
2. Me nënshkrimin e kontratës, subjekti merr në dorëzim me procesverbal sipërfaqen ku do të zhvillojë veprimtarinë e grumbullimit. Pas përfundimit të kontratës, sipërfaqja e marrë në përdorim rikthehet po me procesverbal.
3. Subjekti është përgjegjës për sipërfaqet e marra në dorëzim deri në rikthimin e tyre tek organet pyjore ose tek organi i qeverisjes vendore, si dhe për kryerjen me cilësi të vjeljes e të grumbullimit të bimëve.

Neni 26 **Respektimi i kërkesave teknike**

1. Vjelja, grumbullimi dhe mbledhja e BMET-ve bëhen sipas kërkesave teknike, që përcaktohen në manualin e përmendur në nenin 6 pika 2 të këtij ligji.

2. Kushtet e kërkesat teknike zbatohen për të mbrojtur llojet dhe për të garantuar cilësitë e tyre më të mira pas vjeljes. Ato përfshijnë kërkesa të veçanta për:

- a) kalendarin e mbledhjes e të vjeljes për çdo lloj;
- b) mënyrën, format e mbledhjes e të vjeljes për secilin lloj;
- c) tharjen dhe magazinimin e bimëve të mbledhura;
- ç) paketimin, ambalazhimin, etiketimin dhe transportin e tyre.

Neni 27

Transporti

Transporti i BMET-ve nga pikat e grumbullimit, në fshatra e komuna, për në pikat e përpunimit dhe për eksport, shoqërohet me një vërtetim, të lëshuar nga DSHP-ja ose nga qeverisja përkatëse vendore, që vërteton se këto produkte janë vjelë, përpunuar dhe po transportohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji e të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 28

Llojet në rrezik zhdukjeje

Llojet e BMET-ve, që janë në pakësim apo që rrezikohen të zhduken, përcaktohen në një listë të veçantë nga ministri për çdo vit. Ministri, me urdhër të veçantë, ndalon për një afat të caktuar vjeljen, grumbullimin dhe eksportimin e këtyre bimëve, deri në shtimin dhe ripërtëritjen e tyre.

Neni 29

Përrjashtimi nga vjelja

1. Përrjashtohen përrkohësisht nga vjelja llojet e BMET-ve që:
 - a) kultivohen në ngastra eksperimentale;
 - b) rriten në ngastra ku kryhen punime përrmirësuese;
 - c) ndodhen në ngastra të degraduara.
2. Përrjashtimi bëhet me urdhër të ministrit, ku edhe specifikohen ngastrat e llojet e bimëve, sipas të dhënave të regjistrit të fondit, si dhe periudha e përrjashtimit.

Neni 30

Tarifat

1. Llojet e BMET-ve vilen, mbliidhen e grumbullohen përrkundrejt tarifave, që paguajnë personat fizikë e juridikë të kontraktuar.
2. Përr mbledhjen dhe grumbullimin e BMET-ve, që zhvillohen në pyjet e kullotat në administrim të DSHP-ve dhe në pyjet e kullotat komunale, tarifat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga ministri.

KREU IV KONTROLLI DHE MONITORIMI

Neni 31

Kontrolli

1. Kontrolli ka të bëjë me këqyrjen e veprimtarive mbledhëse të bimëve, të veprimeve të paligjshme mbi bimët dhe me ndëshkimin e shkeljeve të këtij ligji e të akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Të drejtën e kontrollit për zbatimin e këtij ligji e kanë Policia Pyjore, Inspektorati i Mjedisit, për veprimtaritë e pajisura me leje mjedisore, punonjës të ministrisë, të pajisur me autorizim nga ministri dhe inspektorë të organeve vendore të kontrollit, për sipërfaqet pyjore e kullosore që ato kanë në pronësi apo në përdorim.

Neni 32

Monitorimi i fondit të BMET-ve

1. Monitorimi i fondit dhe i llojeve përbërëse të tij nënkupton përfshirjen e tyre në kërkesat e programeve të biomonitorimit, që programohen dhe realizohen si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe kryhet në përputhje me kërkesat e këtij programi, që hartohet nga ministria e miratohet nga ministri.

2. Monitorimi i fondit dhe i llojeve përbërëse të tij, që përfshin monitorimin e treguesve cilësorë dhe sasiorë të tyre, të dukurive natyrore dhe të ndotjes e të dëmtimit të tyre është proces i përhershëm e i detyrueshëm.

Neni 33

Programi i monitorimit

Programi i monitorimit përcakton treguesit e cilësisë së fondit dhe të llojeve pjesëmarrëse në të, të zhvillimit dhe dëmtimit, të dukurive natyrore, mënyrat e grumbullimit e të përpunimit të të dhënave, si dhe raportimin e publikimin e tyre.

Neni 34

Sistemi i të dhënave

1. Sistemi i të dhënave përmbledh tërësinë e treguesve shifrorë, të matshëm e të numërueshëm, që qartësojnë gjendjen e fondit e të llojeve pjesëmarrëse dhe prirjet e proceseve që zhvillohen në to.

2. Në krijimin dhe përsosjen e sistemit të të dhënave, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve synon përafrimin e plotë të tij me sistemet që përdor Agjencia Europiane e Mjedisit e që përcaktohen në direktivat e BE-së.

Neni 35

Grumbullimi i të dhënave

1. Të dhënat për monitorimin e fondit dhe të llojeve pjesëmarrëse në të kërkohen, hartohen e paraqiten sipas rregullave të miratuara me udhëzim të ministrit. Personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, paraqesin të dhënat brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.

2. Të dhënat shoqërohen me shpjegime për interpretimin e tyre, me rekomandime për zgjidhjen e problemeve që dalin dhe dorëzohen në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, në përputhje me formatin e përcaktuar prej saj.

3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve kontrollojnë cilësinë e monitorimit, zbatimin e metodikave, kualifikimin e specialistëve që marrin pjesë dhe vërtetësinë e rezultateve.

KREU V
INFORMIMI DHE TËRHEQJA E MENDIMIT TË PUBLIKUT
NË VENDIMMARRJE

Neni 36

Informimi dhe publikimi i të dhënave

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve përpunon dhe publikon të dhënat e rezultatet që dalin prej tyre, në media dhe shtyp, në një formë të kuptueshme për publikun.

2. Në bazë të të dhënave e të rezultateve të monitorimit, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese, harton krerë të veçantë, në kuadër të raportit vjetor për gjendjen e mjedisit.

3. Publiku dhe organizatat jofitimprurëse informohen për gjendjen e fondit dhe të llojeve pjesëmarrëse në të, nëpërmjet botimit të të dhënave, nga strukturat menaxhuese të pyjeve, nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, nga organet e qeverisjes vendore. Madje ka të drejtë edhe të kërkojë të dhëna pranë këtyre organeve.

Neni 37

Tërheqja e mendimit të publikut në vendimarrje

Gjatë procesit të vendimarrjes për probleme të fondit e të llojeve pjesëmarrëse në të, organet shtetërore, qendrore e vendore sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të komunitetit, të shoqatave të mbledhësve të BMET-ve, si dhe të organizatave jofitimprurëse mjedisore, sipas akteve ligjore e nënligjore, që përcaktojnë tërheqjen e mendimit të publikut në vendimarrje.

Neni 38

Shoqatat e mbledhësve të BMET-ve

Në procesin e zbatimit të këtij ligji, strukturat e menaxhimit të pyjeve dhe organet e qeverisjes vendore përfshijnë edhe shoqatat e mbledhësve të BMET-ve, sidomos në hartimin, miratimin dhe zbatimin e:

- a) strategjive e të planeve të veprimit;
- b) planeve të mbarëshimit e të programeve të monitorimit të fondit të bimëve;
- c) projektakteve normative për mbrojtjen e fondit të bimëve.

Neni 39

Lidhjet me biznesin

Lidhjet me biznesin realizohen në rrugë institucionale, nëpërmjet dhomave të tregtisë dhe të industrisë, si dhe të organizatave profesionale të biznesit, të cilat paraqesin pikëpamjet e tyre për hartimin e zbatimin e programeve të administrimit, të zhvillimit, të mbrojtjes e të shfrytëzimit të BMET-ve.

KREU VI
SANKSIONET

Neni 40

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) vjelja dhe grumbullimi pa kontratë i llojeve të BMET-ve në fondin pyjor dhe kullosor publik dënohet me gjobë nga 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) mbledhja e BMET-ve të rralla, të kërcënuara, në rrezik zhdukjeje, të shpallura të tilla në listën përkatëse, të miratuar nga ministri, dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

c) vjelja dhe grumbullimi i llojeve të BMET-ve, që janë përkohësisht të ndaluara, sepse janë në parcela eksperimentale, në parcela ku kryhen punime përmirësuese apo që janë të degraduara, dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) vjelja dhe grumbullimi i llojeve të BMET-ve jashtë kërkesave teknike për kohën e vjeljes dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

d) vjelja dhe grumbullimi i llojeve të BMET-ve me mënyra e forma që dëmtojnë bimët dënohen me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

dh) transporti i bimëve nga qendrat e grumbullimit për në qendrat e përpunimit apo për eksport, i pashoqëruar me vërtetimin e transportit dhe faturat përkatëse, dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

e) dëmtimi i BMET-ve nga hedhja, braktisja e depozitimi i lëndëve e i mbetjeve radioaktive, brenda sipërfaqeve pyjore, kullotave apo livadheve ku ato rriten dënohet me gjobë nga 70 000 (shtatëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe me detyrimin që kundërvajtësit të pastrojë sipërfaqet e ndotura;

ë) dëmtimi i BMET-ve nga hedhja, braktisja e depozitimi i mbetjeve apo i inerteve brenda sipërfaqeve pyjore, kullotave apo livadheve ku ato rriten dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me detyrimin që kundërvajtësit të pastrojë sipërfaqet e ndotura;

f) dëmtimi i BMET-ve nga hedhja e depozitimi i lëndëve e i mbetjeve kimike brenda sipërfaqeve pyjore, kullotave apo livadheve ku ato rriten dënohet me gjobë nga 70 000 (shtatëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe me detyrimin që kundërvajtësi të pastrojë sipërfaqet e ndotura.

g) dëmtimi i BMET-ve nga hedhja dhe shkarkimi i ujërave të ndotura, industriale dhe urbane brenda sipërfaqeve pyjore, kullotave apo livadheve ku ato rriten dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

gj) dëmtimi i BMET-ve nga përdorimi i pamiratuar i plehrave kimike dhe i pesticideve dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Neni 41

Vlerësimi i dëmit

1. Për çdo rast kundërvajtjeje administrative apo vepre penale, të kryer ndaj fondit, vlerësohet edhe dëmi real që i është shkaktuar fondit të BMET-ve dhe kërkohet zhdëmtimi i tij nga personi përgjegjës.

2. Kriteret për përcaktimin e vlerës së dëmit caktohen sipas pikës 2 të nenit 40/1 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

Neni 42

Dokumentimi

1. Me qëllim që të provohet e të ndëshkohet, shkelja e dispozitave të këtij ligji pasqyrohet në dokumente të standardizuara e të miratuara nga ministri, si procesverbale, akte kontrolli, fletëgjyba.

2. Dokumentet plotësohen nga organet e kontrollit, të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, të cilat, kur vërejnë shkelje të këtyre dispozitave, mbajnë procesverbal, që nënshkruhet nga hartuesi, i proceduari dhe dëshmitarët e pranishëm dhe, kur nuk ka të tillë, procesverbali është i vlefshëm vetëm me nënshkrimin e proceduesit.

Neni 43
Shqyrtimi

1. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative bëhet nga komisioni i shqyrtimit të kundërvajtjeve, që vepron pranë DSHP-së përkatëse ose njësisë të qeverisjes vendore (komunë/bashki), kur kundërvajtja është kryer në pyjet dhe kullotat komunale. Komisioni është organi që vendos ndëshkimin me gjobë.

2. Vendimi për ndëshkimin e kundërvajtjes administrative merret nga komisionet përkatëse, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të procesverbalit, të aktkontrollit apo të fletëgjobës.

Neni 44
Ankimi

1. Ndaj vendimit të komisionit personi mund të ankohet, sipas rastit, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit ose e vënies në dijeni, te drejtori i DSHP-së ose te kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Këta duhet të përgjigjen brenda 20 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

2. Kundër vendimit ose pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kundërvajtësi mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së përgjigjes ose të kalimit të afatit 20-ditor. Ankimi në gjykatë nuk pezullon zbatimin e vendimit.

Neni 45
Pagimi i gjobës

1. Gjoha paguhet brenda 30 ditëve pasi vendimi i komisionit për ndëshkimin me gjobë ka marrë formë të prerë.

2. Vendimi i komisionit për ndëshkimin me gjobë merr formë të prerë, kur nuk është ankimuar nga kundërvajtësi, si dhe kur përgjigja për ankimin e ka lënë në fuqi.

3. Pas kalimit të afatit 30-ditor për pagimin e gjobës, i gjobituri paguan edhe kamatë, në masën 0,1 për qind të vlerës së gjobës, për çdo ditë vonesë deri në 60 ditë.

4. Nëse gjoha dhe kamata nuk paguhen brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, ajo kthehet në titull ekzekutiv dhe vilet nga zyrat e përmbarimit.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 46
Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë urdhrat dhe udhëzimet në zbatim të neneve 6 pika 2, 13 pika 1, 14 pikat 2 e 4, 18 pika 2, 28, 29 pika 2, 32 pika 1 e 35 pika 1 të këtij ligji.

Neni 47
Shfuqizime

Ligji nr.7722, datë 15.6.1993 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, shfuqizohet.

Neni 48
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6161, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

**KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.2976/3, datë 7.4.2009**

Ministria e Financave shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi i degës doganore Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Financave, për pronarët sipas listës emërore:

1. Grigor Spiro Joti = 21,294,819 lekë – plotësim dokumentacioni.
2. Frederik Paskal Prodani = 7,366,086 lekë – plotësim dokumentacioni.
3. Mirela Ismail Papuli = 28,660,905 lekë – plotësim dokumentacioni.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Financave).

Për të gjithë pronarët që është bërë shënimi “plotësim dokumentacioni”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë, pronë private, për interes publik”). Deri në këto momente paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 57 321 810 (pesëdhjetë e shtatë milionë e treqind e njëzet e një mijë e tetëqind e dhjetë) lekë.

**KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.2080/1, datë 6.4.2009**

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shtesë shpronësimi për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, si dhe në bazë të akteve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me

çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Ky publikim bëhet për pasuritë: truall dhe objekte. Vlerësimi i pasurisë truall është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007, ndërsa objektet janë vlerësuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000.

Për të gjithë pronarët është bërë shënimi “Rikonfirmim”, pasi nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Kukës, nuk janë konfirmuar të dhënat e plota, lidhur me titullin e pronësisë. Në materialin përfundimtar që do të dërgohet në Këshillin e Ministrave për miratim, të dhënat do të pasqyrohen sipas konfirmimit që do të merret nga kjo zyrë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 26 107 626.91 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 RRETHI KUKËS

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN
 NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “KALIMASH-MORINË”

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.	Truall			Objekte Vlera lekë	Totali lekë	Vendndodhja	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi/ m ²	Vlera lekë				
1	Xhem	Maksut	Cenaj	1819	83/3	384	2636	1012224	2948401	3960625	Gostil	Rikonfirmim
2	Haxhi	Avni	Matmuja	2912	304/2/34				4995454.77	4995454.77	Perbreg	Rikonfirmim
3	Tafil		Oruçi	1543	191/2				2697028.23	2697028.23	Lagjja Drinas	Rikonfirmim
4	Xhemali	Ajet	Brahaj	1543	193/12				2265619.09	2265619.09	Lagjja Drinas	Rikonfirmim
5	Ajet	Xhem	Brahaj	1543	193/4				2438762.63	2438762.63	Lagjja Drinas	Rikonfirmim
6	Hajdin	Dan	Istrefi	1543	192/2				362554.13	362554.13	Lagjja Drinas	Rikonfirmim
7	Sadik	Shuaip	Dulla	1543	192/8				2180377.31	2180377.31	Lagjja Drinas	Rikonfirmim
8	Han	Shuaip	Dulla	1543	192/3				2180377.31	2180377.31	Lagjja Drinas	Rikonfirmim
9	Fatmir	Shuaip	Dulla	1543	192/9				2198949.56	2198949.56	Lagjja Drinas	Rikonfirmim
10	Musa	Shuaip	Dulla	1543	192/4				2827878.88	2827878.88	Lagjja Drinas	Rikonfirmim
	TOTALI					384		1012224	25095402.91	26107626.91		

KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.2243, datë 3.4.2009

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë-Qafë Plloçë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët, për të cilët në kolonën përkatëse në listën e publikuar është bërë shënimi “I pakonfirmuar” nuk janë konfirmuar të dhënat përkatëse nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë dhe Pogradec. Pronarët në fjalë duhet të aplikojnë për regjistrimin e objekteve për të cilat pretendojnë pronësinë, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Pronarët, për të cilët, në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë, pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 101 029 195 (njëqind e një milion e njëzet e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Oldashi

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

OBJEKTET QE SHPRONESOHEN NE AKSIN RRUGOR KORCE-PLLOCE

	PRONARI	Z.K	Nr. Pasurie	Lloji I objektit	Vlera leke	Vend ndodhje	Shenim
1	Bujar Bilal Lipo	2420	14/65	Shtepi banimi	4041545	Leshnice Pogradec	Konfirmuar nga ZRPP
2	Fadil Bilal Lipo	2420	109/14	Pike Karburanti	4084547	Leshnice Pogradec	Konfirmuar nga ZRPP
3	Hasan Halil Jacelli	3047	154/4	Shtepi+ farmaci	3100435	Petrushe Pogradec	Konfirmuar nga ZRPP
4	Vasil Fari Bardhi	1832	319/16	Pike Karburanti	8284371	Grabovice Pogradec	Konfirmuar nga ZRPP
5	Seladin Kame Muci	1387	284/59/60	Sherbime funerale	1234129	Cerave Pogradec	I Pakonfirmuar
6	Erzen Alimi	1387		Lokal	859248	Cerave Pogradec	I Pakonfirmuar
7	Resmi Lipo	2420		Lokal	1310910	Cerave Pogradec	I Pakonfirmuar
8	Leonard Sami Bregu	1832	252/30	Pike Karburanti	5369492	Grabovice Pogradec	Konfirmuar nga ZRPP
9	Fiqiri Asllani	2965	104/132	Pike Karburanti	1668781	Pirg Korce	Konfirmuar nga ZRPP
10	Albapost	2965	112	Zyre postare	790310.9	Pirg Korce	Konfirmuar nga ZRPP
11	Bedri Njazi Mingo	3736	012/36	Pike Karburanti	9255997	Veliterne Korce	Konfirmuar nga ZRPP
12	Edmond Sefulla Hasimllari	3553	52/27	Pike Karburanti	84564	Symiz Korce	Konfirmuar nga ZRPP
13	Durim Kamber Rakiplllari	3496	1647/25	Pike Karburanti	1404587	Sovjan Korce	Konfirmuar nga ZRPP
14	Sami Fatmir Rakiplllari	3496	157/64	Pike Karburanti	4896789	Sovjan Korce	Konfirmuar nga ZRPP
15	Halil Teki Avdillari	3496	1729/40	Shtepi Banimi	3621101	Sovjan Korce	Konfirmuar nga ZRPP
16	Selami Beshiri	1900	354/6/7	Pike Karburanti	1576219	Gurishte Korce	I Pakonfirmuar
17	Gjergji Sllavi	2521	126/40	Pike Karburanti	782183	Lumalas Korce	I Pakonfirmuar
18	Aurel Agolli	1310	122/32	Pike Karburanti	5863663	Bulgarec Korce	Konfirmuar nga ZRPP
19	Astrit Reshat Gora	3803	275/64	Pike Karburanti	814358	Vlocisht Korce	I Pakonfirmuar
20	Kujtim Alush Merolli	3803	171/44	Pike Karburanti	11611584	Vlocisht Korce	Konfirmuar nga ZRPP
21	Nexhip Alush Merolli	2445	36/1/2	Pike Karburanti	15090879	Libonik Korce	Konfirmuar nga ZRPP
22	Njazi Rapo Cenolli	3716	274/149	Pike Karburanti	8933684	Vashtemi Korce	Konfirmuar nga ZRPP
23	Zija Hyka	3047	135/11	Ndertese	1942177	Petrushe Pogradec	Konfirmuar nga ZRPP
24	Irjat Hyka			Magazine	219378	Petrushe Pogradec	I Pakonfirmuar
25	Gjyshata Bektashiane			Faltore	331236	Bulgarec Korçe	I Pakonfirmuar
26	Sazan Avni Skendo	2445	92/44	Pike Karburanti	381314	Libonik Korce	Konfirmuar nga ZRPP
27	Vladimir Rakiplllari	3496	1571/61	Autoshkolle	3475713	Sovjan Korce	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI				101029194.9		

KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.1870/1, datë 6.4.2009

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shtesë shpronësimi për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, si dhe në bazë të akteve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij.

Ky publikim bëhet për pasuritë: tokë arë, truall dhe objekte. Vlerësimi i pasurisë tokë arë dhe truall është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007, ndërsa objektet janë vlerësuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000.

Sqarojmë se të gjithë pronarët janë në proces rikonfirmimi dhe rivlerësimi. Kjo do të thotë se për të gjithë pronarët do të rikërkohet konfirmim lidhur me titullin e pronësisë si për tokën ashtu edhe për objektet pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Rrëshen, Mirditë, do të kryhen verifikime në terren nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe në varësi të të dhënave që do të rezultojnë nga konfirmimi zyrtar i ZRPP-së Rrëshen dhe nga verifikimet, do të hartohen listat përfundimtare që do të propozohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për sa më sipër mund të ketë ndryshime në sipërfaqe dhe në vlerësimet e objekteve.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë, pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 44 615 718.91 (dyzet e katër milionë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN
 NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RRËSHEN-REPS-THIRRË”

Shënim. Të gjithë pronarët për pasuritë si më poshtë janë në proces rikonfirmimi, riverifikimi dhe rivlerësimi

Nr.	Pronari			Vlera lekë	Fshati
	Emri	Atësia	Mbiemri		
1	Mark		Pergjivukaj	1471965	Zallë-Xhuxhe
2	Gjetë		Pergjivukaj	1738966	Zallë-Xhuxhe
3	Ndue		Frroku	1879745.82	Klos
4	Tonin		Frroku	13894833	Reps
5	Pjetër		Gega	4628465	Pshqesh
6	Zef	Preng	Doda	2154958	Sang
7	Shkurt	Preng	Ndoj	1846683.09	Mashterkor
8	Ndue	Preng	Ndoj	2001723.9	Mashterkor
TOTALI				29617339.81	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRËSHEN-REPS-THIRRE"

Shënim. Të gjithë pronarët për pasuritë si më poshtë janë në proces rikonfirmimi, riverifikimi dhe rivlerësimi

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.	Sip. totale ne pronësi	Tokë Arë			Fshati
	Emri	Atesia	Mbiemri				Sip.m ²	çmimi leke/m ²	Vlera lekë	
1	Nikoll	Mark	Gjoka	2769	267	300100	6088.5	210	1278585	Nderfushaz
2	Aleksander	Zef	Brunga	2769	73/4	33200	12048.8	210	2530248	Nderfushaz
3	Gjergj	Llesh	Perleka	2769	18	4300	1462	210	307020	Nderfushaz
4	Bardhok	Gjon	Perleka	2769	19/3	1000	732.3	210	153783	Nderfushaz
5	Nikoll	Pjeter	Perleka	2769	19/4	1000	837.4	210	175854	Nderfushaz
6	Dava	Llesh	Perleka	2769	19/9	1366	272	210	57120	Nderfushaz
7	Preng	Pjeter	Perleka	2769	19/10	1365	245.2	210	51492	Nderfushaz
8	Gjok	Pjeter	Nikolli	2768	303/3	7250	782.6	248	194084.8	Nderfane
9	Gjok	Pjeter	Nikolli	2768	302/1	450	450	248	111600	Nderfane
10	Dritan	Pjeter	Nikolli	2768	302/5	475	321	248	79608	Nderfane
11	Nikoll	Kol	Nikolli	2768	302/6	475	231	248	57288	Nderfane
12	Ded	Nikoll	Nikolli	2768	302/3	950	174	248	43152	Nderfane
13	Nikoll	Kol	Nikolli	2768	303/25	18075	315.3	248	78194.4	Nderfane
14	Bardhok	Mark	Marku	2768	303/21	34475	142.4	248	35315.2	Nderfane
15	Mehill	Gjok	Bardhaj	2768	315	200	200	248	49600	Nderfane
16	Tonin	Nikoll	Tuci	2768	314	400	327	248	81096	Nderfane
17	Ilijarjan	Dod	Doda	2768	345/24	2075	123	248	30504	Nderfane
18	Ndue	Nikoll	Prenga	2768	345/7	6625	55	248	13640	Nderfane

19	Ndue	Nikoll	Prenga	2768	345/8	4875	245.5	248	60884	Nderfane
20	Frrok	Ndue	Prenga	2768	345/10	5150	690	248	171120	Nderfane
21	Ndue	Frrok	Prenga	2768	345/11	1300	831.3	248	206162.4	Nderfane
22	Ndue	Ded	Feza	2768	339/4	6650	17.6	248	4364.8	Nderfane
23	Dod	Gjet	Doda	2768	256/4	5620	883	248	218984	Nderfane
24	Ndue	Gjon	Prenga	2768	256/5	12800	850	248	210800	Nderfane
25	Gjovalin	Zef	Bardhi	2768	256/6	7939	816.3	248	202442.4	Nderfane
26	Igel	Ndue	Prenga	2768	256/7	31056	360.2	248	89329.6	Nderfane
27	Ndue	Gjok	Nikolli	1713	146/14	1900	273.5	231	63178.5	Gziq
28	Mark	Ndue	Pjetri	2933	152/12	2551	2039	149	303811	Pshqesh
29	Pashke	Ndue	Marku	2933	151	600	107	149	15943	Pshqesh
30	Frrok	Dod	Shtjefni	2933	152/10	1258	74	149	11026	Pshqesh
31	Fran	Ndue	Gjeta	2933	152/11	1806	115	149	17135	Pshqesh
32	Gjovalin	Llesh	Marku	2933	152/8	4146	411.3	149	61283.7	Pshqesh
33	Fran	Ndue	Biba	2933	152/2	2250	144.4	149	21515.6	Pshqesh
34	Pashke	Ndue	Marku	2933	152/4	1829	283	149	42167	Pshqesh
35	Llesh	Gjon	Marku	2933	157/1	1050	360	149	53640	Pshqesh
36	Pashke	Ndue	Marku	2933	157/4	2308	107	149	15943	Pshqesh
37	Pashke	Ndue	Marku	2933	158	1100	255	149	37995	Pshqesh
38	Fran	Ndue	Biba	2933	159	2700	286.3	149	42658.7	Pshqesh
39	Pashke	Ndue	Marku	2933	149	3000	3000	149	447000	Pshqesh
40	Bardhok	Ndue	Prendi	1221	75/3	1201	462	172	79464	Blinisht
41	Anton	Gjin	Prendi	1221	75/2	2131	1198	172	206056	Blinisht
42	Ded	Preng	Prendi	1221	78	3900	144	172	24768	Blinisht
43	Fran	Nikoll	Prendi	1221	91/2	695	695	172	119540	Blinisht
44	Nikolin	Pjeter	Prendi	1221	91/1	7705	1785	172	307020	Blinisht
		TOTALI					41240.9		8362416.1	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONESIMEVE

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRESHEN-REPS-THIRRE"

Shënim. Të gjithë pronaret për pasuritë si me poshtë janë ne proces rikonfirmimi, riverifikimi dhe rivlerësimi

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.	Sip. totale në pronësi	Tokë Arë			Tokë Truall			Vlera totale lekë	Fshati
	Emri	Atesia	Mbiemri				Sip. m ²	Çmim l/m ²	Vlera leke	Sip. m ²	Çmim l/m ²	Vlera lekë		
1	Shkurt	Preng	Ndoj	2610	101	2482				146	887	129502	129502	Mashterkore
2	Zef	Preng	Ndoj	2610	102	1502	276	186	51336				51336	Mashterkore
3	Ndue	Preng	Ndoj	2610	103	1369	265	186	49290				49290	Mashterkore
4	Aleksander	Mark	Sinani	2610	189	3823	694	186	129084				129084	Mashterkore
5	Aleksander	Mark	Sinani	2610	110	4370	13	186	2418				2418	Mashterkore
6	Gjovalin	Zef	Skana	2610	108	1658	30	186	5580				5580	Mashterkore
7	Aleksander	Mark	Sinani	2610	187	950	450	186	83700				83700	Mashterkore
8	Zef	Llesh	Marku	2610	210	421	56	186	10416				10416	Mashterkore
9	Ndue	Llesh	Marku	2610	212	304	41	186	7626				7626	Mashterkore
10	Gjet	Llesh	Marku	2610	215	410	60	186	11160				11160	Mashterkore
11	Gjovalin	Llesh	Skana	2610	218	739	126	186	23436				23436	Mashterkore
12	Zef	Bib	Tuci	2610	227	300				19	887	16853	16853	Mashterkore
13	Ndue	Bib	Tuci	2610	231/1	1217	354	186	65844				65844	Mashterkore
14	Gjet	Preng	Marpepa	2610	238	717	23	186	4278				4278	Mashterkore
15	Zek	Gjon	Marpepa	2610	240	688	201	186	37386				37386	Mashterkore
16	Preng	Gjon	Marpepa	2610	241	682	280	186	52080				52080	Mashterkore
17	Gjet	Llesh	Prenga	2610	160/1	900	142	186	26412				26412	Mashterkore
18	Zek	Gjon	Marpepa	2610	164	429	157	186	29202				29202	Mashterkore
19	Zef	Bib	Tuci	2610	225	3059	450	186	83700				83700	Mashterkore
20	Ndue	Bib	Tuci	2610	228	2415	308	186	57288				57288	Mashterkore
21	Gjet	Llesh	Prenga	2610	133	703	198	186	36828				36828	Mashterkore
22	Gjon	Llesh	Prenga	2610	134	551	22	186	4092				4092	Mashterkore
23	Shkurt	Preng	Ndoj	2610	139	552				150	887	133050	133050	Mashterkore
24	Zef	Preng	Ndoj	2610	141	300				117	887	103779	103779	Mashterkore
25	Ndue	Preng	Ndoj	2610	144	2399	255	186	47430				47430	Mashterkore
26	Dod	Llesh	Ndreca	2610	165/1	96	96	186	17856				17856	Mashterkore
27	Ndue	Dod	Kaza	1893	414/13	675	213	132	28116				28116	G. Bardhe Zajs
28	Dedin	Preng	Koka	1893	414/11	3437	407	132	53724				53724	G. Bardhe Zajs

29	Anton	Fran	Zefi	1893	411	526	77	132	10164				10164	Zajs
30	Gjet	Ndue	Kaza	1893	362	599	599	132	79068				79068	Zajs
31	Gjergj	Zef	Shyti	1893	366	300				300	385	115500	115500	Zajs
32	Mark	Preng	Kaza	1893	368/1	260	220	132	29040				29040	Zajs
33	Gjet	Ndue	Kaza	1893	368/2	689	622	132	82104				82104	Zajs
34	Bardhok		Kaza	1893	370	199	168	132	22176				22176	Zajs
35	Pjeter	Zef	Kaza	1893	334	251	193	132	25476				25476	Zajs
36	Llesh	Gjok	Kaza	1893	342	370	120	132	15840				15840	Zajs
37	Dedin	Preng	Koka	1893	258/2	2503	195	132	25740				25740	Zajs
38	Petrit	Preng	Koka	1893	258/1	2504	290	132	38280				38280	Zajs
39	Dedin	Preng	Koka	1893	261	1567	471	132	62172				62172	Zajs
40	Fran	Ndue	Cera	3433	6	1600	146	153	22338				22338	Shttungaj
41	Ndrec	Ndue	Laska	3443	4	600	570	153	87210				87210	Shttungaj
42	Ded	Gjon	Laska	3443	1	1875	1875	153	286875				286875	Shttungaj
43	Ndrec	Ndue	Gega	1190	27/6	250				250	379	94750	94750	Bisak
44	Ndrec	Ndue	Gega	1190	131/2	600	600	165	99000				99000	Bisak
45	Gjok	Ndue	Gega	1190	27/7	250				250	379	94750	94750	Bisak
46	Simon Nikolin "Koreni"		Lala Shpani Sh.p.k	1190	131/1	600	600	165	99000				99000	Bisak
47	Gjet	Nikoll	Pershqefa	1190	58/1	3700	247	165	40755				40755	Bisake
48	Preng	Gjet	Prenga	2162	83	200	136	145	19720				19720	Klos
49	Dava	Gjet	Prenga	2162	81/1	1800	46	145	6670				6670	Klos
50	Nikoll	Llesh	Prenga	2162	81/2	1300	130	145	18850				18850	Klos
51	Preng	Mark	Mena	2162	81/13	1500	307	145	44515				44515	Klos
52	Gjin	Zef	Tuci	2162	81/4	1250	138	145	20010				20010	Klos
53	Frrok	Zef	Lleshi	2162	88/5	300				250	362	90500	90500	Klos
54	Dava	Nikoll	Tuci	2162	84/12	400	100	145	14500				14500	Klos
55	Gjet	Ndrec	Lleshi	2162	130/3	1008	207	145	30015				30015	Klos
56	Kol	Ndue	Lleshi	2162	99/8	1100	46	145	6670				6670	Klos
57	Ndue	Gjet	Marku	2162	99/7	1050	114	145	16530				16530	Klos
58	Preng	Gjet	Marku	2162	99/6	4200	254	145	36830				36830	Klos
59	Pjeter	Preng	Marku	2162	99/5	2600	15	145	2175				2175	Klos
60	Ndue	Pjeter	Marku	2162	99/4	2450	292	145	42340				42340	Klos
61	Preng	Pjeter	Marku	2162	99/2	2250	55	145	7975				7975	Klos
62	Frrok	Pal	Margjeci	2162	106	1550	629	145	91205				91205	Klos
63	Ndue	Frrok	Frroku	2162	104/1	250	250	145	36250				36250	Klos
64	Kujtim	Mark	Frroku	2162	104/2	300	300	145	43500				43500	Klos
65	Ndue	Frrok	Frroku	2162	103/1	200	200	145	29000				29000	Klos
66	Kujtim	Mark	Frroku	2162	103/2	100	100	145	14500				14500	Klos
67	Ndue	Frrok	Frroku	2162	105	1200	1200	145	174000				174000	Klos
68	Kujtim	Mark	Frroku	2162	107/8	250				250	362	90500	90500	Klos

69	Ndue	Frrok	Frroku	2162	107/9	250				250	362	90500	90500	Klos
70	Kujtim	Mark	Frroku	2162	107/10	1100	30	145	4350				4350	Klos
71	Gjet	Preng	Frroku	2162	126/1	900	94	145	13630				13630	Klos
72	Dod	Nikoll	Pershqefa	1600	2//3	300				300	327	98100	98100	Fan
73	Niko	Ded	Pershqefa	1600	2//2	200				200	327	65400	65400	Fan
74	Eduart	Preng	Kola	1600	10//2	10204	1850	138	255300				255300	Fan
75	Mark	Preng	Gjoka	1600	10//3	4141	533	138	73554				73554	Fan
76	Pashk	Zef	Gjoka	1600	10//7	1795	229	138	31602				31602	Fan
77	Dritan	Ndue	Gjoka	1600	10//6	4395	911	138	125718				125718	Fan
78	Gjon	Ndue	Deda	3883	54	1800	420	137	57540				57540	Zall- Xhuxhe
79	Ferdinand	Ded	Deda	3883	197	300	248	137	33976	300	338	101400	135376	Z- Xhuxhe
80	Dava	Zef	Qafa	3883	20	2750	474	137	64938				64938	Zall- Xhuxhe
81	Dava	Ded	Gjaci	3883	16/1	2000	210	137	28770				28770	Zall- Xhuxhe
82	Ndue	Preng	Nikolli	3883	17	3950	2922	137	400314				400314	Zall- Xhuxhe
83	Nikolin	Zef	Gjaci	3883	15/4	4400	212	137	29044				29044	Zall- Xhuxhe
84	Ndue	Preng	Nikolli	3883	187	300				300	338	101400	101400	Zall- Xhuxhe
85	Llesh	Ndue	Lleshi	3259	156	1100	1100	219	240900				240900	Sang
86	Marte	Ndrec	Lleshi	3259	159	800	393	219	86067				86067	Sang
87	Mark	Ndue	Lleshi	3259	157	2070	63	219	13797				13797	Sang
88	Ndue	Zef	Lleshi	3259	139	1000	107	219	23433				23433	Sang
89	Bashkim	Ndue	Pepa	3259	116/2	1250	27	219	5913				5913	Sang
90	Nikolin	Gjon	Nikolli	3259	115	2333	225	219	49275				49275	Sang
91	Gjergj		Loka	3259	209	300				25	292	7300	7300	Sang
92	Gjergj	Zef	Doda	3259	108/2	1400	132	219	28908				28908	Sang
93	Fran	Zef	Doda	3259	108/3	1300	122	219	26718				26718	Sang
94	Ded	Nikoll	Prenga	3259	103/2	600	100	219	21900				21900	Sang
95	Pal	Preng	Prenga	3259	104/1	2700	1101	219	241119				241119	Sang
96	Mark	Preng	Prenga	3259	106	1300	378	219	82782				82782	Sang
97	Ndue	Preng	Prenga	3259	105	1400				67	292	19564	19564	Sang
98	Mark	Preng	Prenga	3259			679	219	148701				148701	Sang
99	Ndue	Preng	Prenga	3259			451	219	98769				98769	Sang
100	Preng		Prenga	3259			26	219	5694				5694	Sang
101	Ded	Preng	Prenga	3259			406	219	88914				88914	Sang
102	Nikoll	Gjon	Prenga	3598	244	300				300	298	89400	89400	Thirre
103	Gjon	Zef	Pjetri	3598	77/2	3070	134	158	21172				21172	Thirre
104	Gjon	Zef	Pjetri	3598	76/1	6060	650	158	102700				102700	Thirre
105	Gjin	Gjergj	Pjetri	3598	26/3	2450	377	158	59566				59566	Thirre
106	Llesh	Gjok	Pjetri	3598	127/1	3300	444	158	70152				70152	Thirre
107	Llesh	Gjergj	Pjetri	3598	127/2	800	199	158	31442				31442	Thirre
108	Llesh	Gjergj	Pjetri	3598	224	300	179	158	28282				28282	Thirre
		TOTALI					32055		5193715	3474		1442248	6635963	

VENDIM
Nr.26, datë 9.4.2009

PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS ME NR.16, SERIA PV04P, PËR PRODHIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE, LËSHUAR SHOQËRISË “WTS ENERGJI” SHPK, ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S, NR.39, DATË 22.7.2004

Në mbështetje të nenit 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 14 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.4.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 22.7.2004,

dhe konsatoi se:

- Me vendimin nr.2, datë 22.1.2009, Bordi i Komisionerëve filloi procedurat për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, të shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 22.4.2004.

- Aplikimi i shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 22.7.2004, është në përputhje me dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Në licencën me nr.16, seria PV04P, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.39, datë 22.7.2004, të bëhet ndryshimi i fuqisë së instaluar të HEC Selce nga 75 kW në 400 kW.

2. Shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. t’i lëshohet licenca me përmbajtje të ndryshuar ku reflektohet ndryshimi i mësipërm.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.**

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 13.5.2009
Doli nga shtypi më 14.5.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë